

VENDIM
Nr.824, datë 6.12.2006

PËR MIRATIMIN E INSTITUCIONEVE TË AUTORIZUARA PËR VERIFIKIMIN, NË MËNYRË ELEKTRONIKE, TË GJENDJES GJYQËSORE, SI DHE TË FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT¹

(Ndryshuar me VKM nr.6, datë 4.1.2008; nr.1425, datë 22.10.2008; nr.1276, datë 23.12.2009; nr.751, datë 8.9.2010; nr.350, datë 29.4.2015; nr.31, datë 18.1.2017)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 7, 8, e 11 të ligjit nr.9614, datë 21.9.2006 “Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Institucionet, që autorizohen për verifikim, në mënyrë elektronike, të gjendjes gjyqësore, janë:

1. Zyra e Presidentit të Republikës;
2. Këshilli i Lartë i Drejtësisë;
3. *Prokuroria e Përgjithshme dhe prokuroritë e rretheve gjyqësore;*
4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
5. Ministria e Drejtësisë;
- 6 *Ministria e Punëve të Brendshme;*
7. Ministria e Mbrojtjes;
8. *Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës;*
- 8/1. *Ministria e Zhvillimit Urban;*
9. Ministria e Punëve të Jashtme;
10. *Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;*
11. Ministria e Financave;
12. *Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;*
13. Shërbimi Informativ i Shtetit;
14. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
15. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
16. Interpoli;
17. Garda e Republikës;
18. Departamenti i Administratës Publike;
19. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
20. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

¹ *VKM nr.824, datë 6.12.2006 është botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.54, qershor 2010.*

VKM nr.6, datë 4.1.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.1, datë 10 janar 2008.

VKM nr.1425, datë 22.10.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.170, datë 10 nëntor 2008.

VKM nr.1276, datë 23.12.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.68, gusht 2010.

VKM nr.751, datë 8.9.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.132, datë 1 tetor 2010.

VKM nr.350, datë 29.4.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.72, datë 11 maj 2015.

VKM nr.31, datë 18.1.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.9, 25 janar 2017.

21. Përfaqësitë diplomatike, me autorizim të Ministrisë së Punëve të Jashtme;
 22. Banka e Shqipërisë;
 23. Përfaqësia e Bashkimit Europian në Republikën e Shqipërisë;
 24. Përfaqësia e Këshilit të Europës në Republikën e Shqipërisë;
 25. Përfaqësia e NATO-s në Republikën e Shqipërisë.
 26. *Ministria e Arsimit dhe Sportit;*
 27. *Gjykata Kushtetuese;*
 28. *Enti Rregullator i Energjisë;*
 29. *Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;*
 30. *Ministria e Mbrojtjes për Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe Agjencina e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;*
 31. *Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe Drejtorinë Rajonale të Punësimit, Tiranë;*
 32. *Ministria e Shëndetësisë, për Drejtorinë e Shëndetit Publik, Pogradec;*
 33. *Ministria e Financave, për Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore;*
 34. *Këshilli i Ministrave, për Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;*
 35. *Ministria e Punëve të Brendshme, për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat;*
 36. *Ministria e Punëve të Jashtme, për shërbimet diplomatike;*
 37. *Konrolli i Lartë i Shtetit;*
 38. *Bashkia Korçë.*
 39. *Autoriteti i Aviacionit Civil;*
 40. *Shkolla e Magjistraturës;*
 41. *Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU).*
 42. *Kryeministria;*
 43. *Ministria e Integritetit Evropian;*
 44. *Instituti i Sigurimeve Shoqërore;*
 45. *Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.*
- Institucionet e tjera, që kërkojnë të autorizohen për verifikim, në mënyrë elektronike, të gjendjes gjyqësore i paraqesin kërkesë Ministrisë së Drejtësisë.*
- I/1. Institucionet e autorizuar, gjatë verifikimit elektronik të gjendjes gjyqësore, marrin masat për respektimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.*
- II. Miratimin e formularit të vetëdeklarimit, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- III. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe subjektet e tjera, që përcaktuara në këtë vendim, të caktojnë personin përkatës, që do të ketë akses për të përfutur të dhënat e parashikuara në pikën 8 të nenit 2 të ligjit nr.9614, datë 21.9.2006 “Për certifikatat elektronike të gjendjes civile gjyqësore”, brenda një afati prej 10 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
- III/1. Institucionet e parashikuara në pikën 1 konfirmojnë gjendjen gjyqësore të personit të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit nëpërmjet sistemit elektronik fingerprint dhe nuk mund të kërkojnë më paraqitjen e dëshmisë së penaltetit, të lëshuar nga zyra e gjendjes gjyqësore. Përfundim nga ky rregull bën institucioni i prokurorisë.*
- IV. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR VETËDEKLARIMI

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Mbiemri, Emri Atësia/Amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (një kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: *i/e padënuar* *i/e dënuar*

DEKLARUESI

MARRËSI I VETËDEKLARIMIT

 Emër, mbiemër/firmë

 Emër, mbiemër/firmë / vulë

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga _____

Subjekti i autorizuar

 Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

 Data e nënshkrimit

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me *ligjin nr.9887, datë 10.3.2008* “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme.